



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr. 104/02-32169/22
Kaçanik, 29.12.2022

Në mbështetje të nenit 11 dhe 12.2 (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 73 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës të nxjerrë në bazë të Kërkesës së Qendra “Gjenocidi në Kosovë- Plagë e hapur” 01Nr. 104/02-32169/22 prej datës 06.12.2022, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 29 Dhjetor 2022 mori këtë:

**VENDIM
PËR MIRATIMIN E SIMBOLIT PËRKUJTIMOR
TË GJENOCIDIT NË KOSOVË**

1. Me këtë Vendim, MIRATOHET propozimi që **“LULËKUQJA ME KATËR PETALE”** të bëhet Simbol Unik Përkujtimor i Gjenocidit në Kosovë.
 2. Simboli i përcaktuar nga pika 1. e këtij vendimi, paraqet katër format e akteve gjenocide që Republika e Serbisë i zbatoi në Republikën e Kosovës, si vrasjen, dhunën seksuale, spastrimin etnik, dhe shkatërrimin e objekteve që lidhen me përkatësinë etnike dhe identitetin shqiptar.
 3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është, Kërkesa e Qendra “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur” me simbolin e propozuar.
 4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të MAPL, respektivisht 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
- Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme (përmes tyre njoftohen mekanizmat tjerë relevantë); Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr. 07-104/02-33334/22
Kaçanik, 29.12. 2022

Në bazë nenit Në bazë të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17 (f) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/4 Qershor 2008), të nenit 10 lidhur me nenin 13 paragrafi 2 pika 1 dhe nenit 15 të Ligjit për Mbeturina Nr. 04/L-060 (Gazeta Zyrtare Nr. 04.L-060 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17/29 Qershor 2012). të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, të nenit 4 të Rregullores 01Nr. 07-60/01-17890/19 - Për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Kaçanikut, të nenit 6.2, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 28 Korrik 2022 mori këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E PLANIT KOMUNAL PËR MENAXHIMIN E
MBETURINAVE 2023-2027

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani komunal, me tekstin e mëtejshëm "Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027".
2. Plani komunal nga pika 1 e këtij vendimi, mundëson zbatimin e politikave kombëtare në nivel lokal, orientimin strategjik të komunës drejt menaxhimit të integruar e të qëndrueshëm të mbeturinave, qasje të qartë të politikave të menaxhimit, mirëqeverisjen ngritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e kuadrit rregullues ligjor.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është: Plani Komunal 07-104/02-33334/22 -Për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, i përmbledhur në 46 faqe.
4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Emergjencave dhe Shërbimeve Publike dhe mekanizmat tjerë relevantë.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria e Emergjencave dhe Shërbimeve Publike (përmes kësaj drejtorie njoftohen mekanizmat tjerë relevantë); Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli